



Prishtinë, 05 qershor 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1155_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën me me P – 70202063 -932-1, ZK Ceceli, me kapacitet të instaluar prej **5 kW** në Komunën e Vushtrrisë, të datës 10.04.2019 me nr. prot. 227/2019 të aplikuesit Sead Hajredinaj, me adresë: fshati "Ceceli", Komuna e Vushtrrisë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 05 qershor 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET-** kërkesa e aplikuesit Sead Hajredinaj për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën me P – 70202068 -932-1, ZK Ceceli, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, që do të vendosen mbi objekt, Komuna e Vushtrrisë.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi Sead Hajredinaj me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DMI-9057017 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi Sead Hajredinaj do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


A r s y e t i m



- ZRRE, me datë 15.04.2019 nga aplikuesi Sead Hajredinaj ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, mbi objektin e ndërtuar në parcelën me P – 70202068 -932-1, ZK Ceceli, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, shifra e konsumatorit DMI-9057017, Komuna e Vushtrrisë.
 - Aplikuesi, s’bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 2166 të datës 05.04.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Vendimin Nr. 1019/18 të datës 18.12.2018 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vushtrrisë.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit Sead Hajredinaj, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e shtëpisë individuale të ndërtuar në parcelën P – 70202068 - 932-1, ZK Ceceli, me kapacitet të instaluar prej **5 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, çilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:



Arsim Janova, u.d. Kryesues



Besim Sejfiqaj, anëtar



Selman Hoti, anëtar



Izet Gushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Vushtrrisë,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.